REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
Urbanistika

RELACION PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË TË BASHKISË HAS.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Has

BAZA LIGJORE

Mbështetur në nenin 8 pika 2, nenin 24 pika 1, nenin 64 pika c, të ligjit Nr. 139/2015, "PËR VETËQEVERISJEN VENDORE"; nenin 3/1-b, nenet 4, 5 , 13, 14, 15^{6}, $16^{a-b-xiv}$, 24 dhe nenin 30, të ligjit **Ligji Nr.22/2018 "Për strehimin social";** VKM nr.814, datë 03.12.2004, "Për Normat e Strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit"; VKM nr.574, datë 29.08.2012, "Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t'u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore"; VKM Nr. 1093, datë 28.12.2015 "Për miratimin e procedurave, kritereve dhe përparësive për dhënien e bonusit të strehimit"; udhëzimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit VKM nr.23, datë 30.12.2008, për "Përmbajtjen e bonusit të strehimit"; Sektori Urbanistikes, Strehimit dhe Shërbimit Social.

Theksojmë se ,bazuar në legjislacionin në fuqi ,përfitojnë bonus strehimi nga buxheti i shtetit , kategoritë e familjeve të parashikuara në nenin 46 , të ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social" të cilat janë : kryefamiljarët me aftësi të kufizuara ; individë me status të jetimit ; kryefamiljarët e vetëm me fëmijë ; familjet njëprindërore ; vajzat nena ; familjeve që kanë në përbërjen familjare persona me aftësi të kufizuar dhe invalidë, familjet që trajtohen me ndihme ekonomike si dhe familjet me te ardhura mujore të ulëta . Kusht për përfitimin e fondit të bonusit të qirasë nga buxheti i shtetit është që familjet që do të trajtohen me bonus qiraje, duhet të mbulojnë pjesën e mbetur të qerasë me të ardhurat e tyre, (sipas tabelës bashkëlidhur relacionit). Komisioni i Strehimit i mbledhur me datë 21.01.2026 pasi mori në shqyrtim të gjitha kërkesat e bëra për bonus strehimi, rezultoi se mbas shqyrtimit të kërkesave u kualifikohen 112 familje, ndërsa 17 kërkesa u s'kualifikuan për mungesë dokumentacioni ose që nuk plotësonin kushtet ligjore për t'u trajtuar me bonus qiraje. Kërkojmë nga ana juaj miratimin e listës së familjeve të përbërë nga 112 familje që u kualifikuan nga Komisioni i Strehimit. Bashkëlidhur lista e familjeve përfituese.

Konceptoi: Besart Hoxha _____